

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2001/35, mbi Pensionet në Kosovë, të datës 22 Dhjetor 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut me Nr.2001/35, mbi definimin e Pensionit me Benefit të Definuar dhe Pensionit me Kontribut të Definuar.

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës (BPK), në mbledhjen e tij të mbajtur më 23 tetor 2002 miraton si vijon:

Rregulla 16 mbi Vlerën e Kontributeve të Pensionit

Neni 1

Sfera dhe qëllimi i Rregullës

1.1 Sfera e Rregullës

Kjo Rregull i adresohet Fondit Suplementar Pundhënës të Pensionit (“Fondi i Pensionit”), dhe aty ku gjen aplikim, për Pensionet Individuale Suplementare (Siguruesi i Pensionit).

1.2 Qëllimi i Rregullës

Kjo Rregull themelon disa direktiva për determinimin e vleres që mundë të kontribuohet për programin e Pensionit në mënyrë që të siguroj integritetin, mbështetshmërinë, dhe dhënjen e pensioneve, dhe të përkrah standardet e drejta dhe të favorshme për shpërndarjen e benefiteve të Pensionit, veqanrisht gjatë viteve kur pensionet janë të njohura dhe të zhvilluara në Kosovë.

Neni 2

Dispozitat e përgjithsme

2.1 Definimi

Të gjitha termet e shfrytzuara në këtë Rregull janë ashtu siq janë definuar dhe caktuar në Rregulloren e Pensionit dhe/ose siq janë definuar më tutje në këtë Rregull.

“Supozimet aktuariale” i referohen vargut të vlersimeve që janë shfrytzuar për të llogaritur kontributet për të determinuar benefitet e pensionit në Rregullimin Pensional me Benefit te Definuar. Kjo ka të bëjë me zhvillimet e ardhshme që do të kenë ndikim në financimin e benefiteve të pensionit që në mes tjerash e kushtzojnë, shkalla e interesit, shkalla e mortalitetit, shkalla e pa aftësis, shkalla e përfundimit, shkalla e rritjes së rrogës ose ndryshimet në kulturën e përgjithshme të kompenzimit.

“Pagat” nënkupton rrogën totale vjetore ose të ardhurat e rrogave të një individi siq është definuar nga ligjet e taksave të aplikueshme të të ardhurave që janë në fuqi, në Kosovë. “Baza e fitimeve të pensionit” nënkupton fitimet ose pjesën e fitimeve të pjesmarrësit, shuma e të cilave mund të definohet në Urdhëresat e Pensionit ose Rregullat e Pensionit, të shfrytzuara si baza për llogaritjen e shumës së kontributeve të Pensionit dhe benefiteve.

Neni 3

Shuma e kontributeve për Rregullimin Pensional

3.1 Baza e fitimeve të Pensionit

Urdhëresa e Pensionit ose Rregulla e Pensionit mundë të determinojnë vlerën e Fitimit të Bazës së Pensionit, si baze për determinimin e kontributeve në qdo vit për Pensionin Individual ose Suplementar Pundhënës. Përcaktimet e shumës së Bazës së Fitimit të Pensionit varen nga kushtet:

- a) Shuma nuk duhet të tejkaloj Fitimin(et) aktual të pjesmarrësit, në lidhje me treguesin e aplikueshëm në skemën e pensionit me Benefit të Definuar.
- b) Shuma, e treguar e indeksuar apo jo (indeksit do të thotë ngritje ose zbritje p.sh në relacion me koston e jetesës), nuk duhet të tejkaloj 24,000 Euro, për vit.

Kufizimi i kontributeve vjetore, i përmendur më lartë, nuk i adresohet vlerës së benefitit të pensionit të pjesmarrësit të Pensionit Suplementar Pundhënës që është transferuar për pensionet e kursyera si rezultata i përfundimit të rregullimit pensional ose për shumën e transferuar te siguruesi i ri i pensionit në pajtim me Rregullën 20 të kësaj Rregulle.

3.2 Shaku kryesor i kufizimit të vlerës së kontributeve

Gjatë viteve formuese në zhvillimin e pensioneve suplementare, është e nevojshme që të përshkruhet vlera maksimale e kontributeve që mundë të bëhen nga ose në emër të pjesmarrësit për arsye si vijojnë:

- a) Vazhdimësia. Pensionet duhet të kërkojnë vetëm shumën e kontributeve që siguron vazhdimësinë e programit të pensionit duke marrë parasysh ndryshimet afat-gjate që mundë të ndikojnë në vlerën e pensionit ashtu që të siguroj të ardhura të arsyeshme dhe të favorshme për pensionist.
- b) Mundësia për të dhënë. Varsisht prej standardeve të vazhdueshmërisë, nivelet e kontributeve për programin e pensionit duhet të jenë ashtu që të sigurojnë që ato të mbeten në atë gjendje që të mundësojnë dhënjën për pjesmarrësit dhe Pundhënësit.
- c) Integriteti i programit të pensionit. Rregullimet pensionale duhet të përparohen dhe të ndërmerren vetëm me qëllim të sigurimit të benefiteve të pensioneve. Nuk

duhet të shfrytzohej për të shërbyer për investimet e lira ose qëllime tjera spekulative të individve.

- d) Paansia dhe drejtsia në shpërndarjen e benefiteve të pensionit. Momentalisht ka zbrastira të mëdha në nivelet e kompensimit ndërmjet shumicës së nëpunësve dhe puntorve me kta në rangjet më të larta të shkallës së hierarkisë, veqanrisht me nëpunësit e menagjmentit që janë “lartë të komenzuar”. Ky kusht, nëse lejohet i pakontrolluar që të ndikoj në kontributet e rregullimit pensional, mundë të shkaktojë shtremëbrim në benefitet e pensionit në atë mënyrë që rregullimi pensional të sigurojë benefite disproporcionale për pjesmarrësit. Benefitet e pabalancuara të pensionit mundë të shkaktojë fyerje të panevojshme në fuqin e përgjithshme puntore, veqanrisht kur një pjesë apo gjithë kontributet janë bërë nga Pundhënësi. Për më tutje, kjo përkrah zvoglimin e zgjerimit të ndarjeve ekonomike ndërmjet të punonjësve lartë të kompenzuar dhe atyre të paguar ult.
- e) Drejtsia në zhvillimin e nxitjes së taksave. Politikat fiskale mundë të nxitin ligjin e Tatimit dhe mbështetin sistemin që do të lejon akumulimin optimal të mjeteve të pensionit ashtu që pjesa ose gjithë kontributet dhe fitimet e nxjerrura prej këtu, koh pas kohe, favorizohen me shtyrjen e taksave ose mjeteve tjera fiskale. Efekti i shtyrjes së taksave dhe/ose përjashtimi total nga tatimi shërbejnë më shumë përparsive me kuptim për pranuesit e “me të ardhura më të larta” dhe pastaj kjo i ofron shumicës së pjesmarrësve. Limitimi i vlerës së kontributeve të pensionit e thjeshton administrimin e pensionit në kontabilitet dhe në raportimin e të drejtave të pjesmarrësve dhe obligimeve në efektet e mjeteve të tilla fiskale.

3.3 Shuma maksimale e kontributeve

- a) Pensioni Suplementar Pundhënës. Kontributi maksimal për pjesmarrësin në Pensionin Pundhënës Suplementar ((Fondi i Pensionit), për qdo vit, duhet të jetë konform me të gjitha kërkesat si vijojnë:
 - 1. Kontributi total vjetor për pjesmarrësin në pensionin me benefit të definuar nuk duhet të tejkaloj (3) herë shkallën e rritjes për vit të kohës së shërbimit të Bazës së Fitimit të Pensionit të asaj/atij.
 - 2. Kontributi total vjetor i pjesmarrësit në pensionin me Benefit të Definuar nuk duhet të tejkaloj 30 % të Bazes së Fitimeve të Pensionit të pjesmarrësit, ose 20% prej ktu, nëse pjesmarrësi gjithashtu merr pjesë në Pensionet e Kursimit.
 - 3. Nëse edhe Pundhënësi dhe pjesmarrësi kontribuojnë në pensionin me Benefit të Definuar, kontributi i pjesmarrësit nuk duhet të jetë më i lartë se kontributi i Pundhënësit.
- b) Pensioni Suplementar Individual. Është përgjegjësi e qdo Siguruesi të Pensionit që të sigurojë pjesmarrësit individual me Pensionet e tyre Suplementare

Individuale, një program të pensionit që është i përshtatshëm për pjesmarrësit duke pasur në konsideratë fitimet e asaj/atij si dhe nivelin e tolerancës së rrezikut. Siguruesi i Pensionit duhet të bëjë një paraqitje adekuate të të drejtave dhe obligimeve të pjesmarrësit të mjaftueshme për ate/atë që të formojë një vendim mbi dhënjën e kontributeve të kontraktuara në relacion me benefitet e pensionit.

Siguruesit e Pensionit që sponzorojnë skemën me Kontribut të Definuar duhet të sigurojnë mundësinë e pjesmarrësit që të suspendojë, reduktoj ose ndal kontributet e tyre, varsisht prej të drejtave të tij që të ngarkojë me taksa të arsyeshme vetëm nëse:

1. Natyra dhe vlera e taksave të tilla janë përcaktuar dhe përshkruar në detale në Rregullat e Pensionit, dhe
 2. Nëse taksat e tilla ju janë komunikuar pjesmarrësve në kohën e regjistrimit, dhe
 3. Siguruesi i Pensionit njohton pjesmarrësin me shkrim për natyrën e vlerës dhe taksave para se ti bëjë ato ngarkime; të sigurojë këte në rast të ndërprerjes së kontributeve njohtimi duhet të përfshijë përshkrimin e të drejtave të pjesmarrësit për pensionin e shtyer ose opcionet e transferit.
- c) Lehtësimet e tatimit. Autoriteti i Taksave mundë të përshkruaj, kohë pas kohe, limitet e vlerës maximale të kontributeve të pensioneve që do të favorizohen me shtyrje të taksave dhe mjeteve tjera fiskale.

Neni 4 Hyrja në fuqi

Kjo rregull do të hyj në fuqi më 23 tetor 2002.

Drejtori i Përgjithshëm